



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:241596

Datë: 20.12.2023

Numri i dokumentit: 05097142

C-IV-15-1165

Paditësi: **Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës**, lagja Dardani, Prishtinë.

Kundër:

E paditur: **NSH “Prizreni Trans”-Prizren**, e përfaqësuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, Rr. Driton Hoxha nr. 55, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimi, me gjyqtarin Hasim Sogojeva, me 20 dhjetor 2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

Ankesa/Kërkesa e paditësit, Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës, kundër Vendimit të AKP /AL për NSH “Prizreni Trans”, PRZ 047-0009, më dt. 03.06.2015, konsiderohet e tërhequr.

Rrethanat Faktike dhe Procedurale

Me 22.06.2015, Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës – PTK, në DHPGJS ka dorëzuar ankesën/padinë kundër Vendimit të AL të AKP-së, për NSH “Prizreni Trans”, PRZ 047-0009, dt. 03.06.2015, me të cilin është refuzuar kërkesa për pagesën e faktuarve të papaguara në shumë prej 4.140,75 euro.

Kësaj parashtrëse nuk ja ka bashkangjitur asnjë provë.

Më 13.12.2022, DHPGJS ka lëshuar Urdhër C- IV- 15-1165 për paditësen/ankuesen, me të cilin i ka kërkuar të dorëzon një kopje të Vendimit ndaj të cilit është ankuar, të dorëzoj provat si: faturat, ekstraktin për borxh të vërtetuar dhe nënshkruar nga personat përgjegjës. Po ashtu ka

kërkuar që të paguhet taksa gjyqësore. Paditësi është njoftuar për pasojën juridike të mos veprimit.

Me 27.12.2022, paditësi/ankuesi ka dorëzuar në gjykatë, parashtrësën, me të cilën ka bashkangjitur edhe provat si:

- Kopjen e Vendimit të AL-së.
- Njoftimin lidhur me likuidimin e NSH të Regjionit të Prizrenit.
- Listat e shpenzimeve nga NSH "Prizreni Trans".

Paditësi nuk dorëzoi edhe provën për pagesën e taksës gjyqësore .

Më 04.01.2023, AKP përmes përfaqësuesit ka dorëzuar mbrojtjen në ankesë të datës 22.06.2015, duke e kundërshtuar në tersi Ankesën e paditësit/ankuesit ashtu që ka propozuar të refuzohet ankesa si e pa pranueshme ose e pa bazuar dhe të vërtetohet Vendimi i AL-së..

Në parashtrësë është deklaruar se NSH "Prizreni Trans". është në procedurë të likuidimit nga data 16.12.2013. Më dt. 06.02.2014, ankuesi ka paraqitur kërkesë për pagesën e faktuarve të papaguara në shumë prej 4.140,75 euro. Me këtë AL mori vendim me dt. 03.06.2015, përmes të cilit e refuzoj Kërkesën e parashtruesit. Vendimi është i bazuar në fakte dhe bazat ligjore. AKP konsideron se pretendimet e ankuesit janë të parashkruara, për arsye se kërkesa është dorëzuar ma vonë se 1 vit, nga momenti që NSH pretendon se nuk i janë kryer obligimet e saj që rrjedhin nga marrëdhënia kontraktore, për shërbimet telefonike.

Arsyetimi ligjor

Ankesa/ kërkesa e paditësit, konsiderohet e tërhequr.

Paditësi nuk e ka paguar taksën gjyqësore .

Bazuar në nenin 5.5.2 të Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2017, hyrë në fuqi më 01 maj 2017, për aplikimin e njëjtë të taksave gjyqësore, paditëses i kërkohet që brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga të shërbyerit dhe pranimi i urdhrin të gjykatës për të ia dorëzuar Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës vërtetimin dhe faturën e pagesës të shumës së caktuar që duhet paguar ose që t'i dorëzojë gjykatës prova në lidhje me faktin se ai është i liruar nga pagesa për arsye se është përfitues i ndihmës sociale nga ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ose Ndihmës Ligjore nga Zyra për Ndihmë Juridike.

Udhëzimi Administrativ nr. 01/2017, për unifikimin e tarifave gjyqësore, neni 5 paragrafi 5.1, parashikon detyrimin e të gjithë atyre që i drejtohen Gjykatës për të paguar taksat gjyqësore për procedimin në shumën e duhur, ashtu që sipas neni 13 të Udhëzimit Administrativë nr. 01/2017, për unifikimin e taksave gjyqësore është caktuar taksa.

Për më tepër, Udhëzimi Administrativ nr. 01/2017, neni 5.5.2 parasheh që, "nëse pas njoftimit, pala nuk i paguan taksat gjyqësore, sipas neni 5.1 të këtij udhëzimi, gjyqtari i caktuar për

çështjen, do të aplikojë nenin 253, paragrafi 5 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore dhe si pasojë padia do të konsiderohet e tërhequr.

Paditësi/ankuesi përmes Urdhrit C- IV- 15-1165 dt. 13.12.2023, u informua për faktin se në bazë të nenit të lartpërmendur të Udhëzimit Administrativ, në rast të mos pagesës së taksës, Gjykata do të marrë një vendim duke e konsideruar të tërhequr ankesën.

Meqenëse paditësi/ankuesi, deri në ditën e marrjes së vendimit nuk e ka dorëzuar dëshminë për pagesën e taksës gjyqësore, gjykata në kuptim të dispozitës së nenit 253. 5 të LPK-së, ankesën/kërkesën e paditësit e konsideroi të tërhequr.

Këshillë Juridike:

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë, me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditësh, nga pranimi i këtij aktvendimi.

Hasim Sogojeva, Gjyqtar